

SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A-47/11

Prishtinë

Në çështjen ligjore të

24 gusht 2011

J.M.

Ankuesi

kundër.

S.P.V.

a

Paraqitësi i kërkesës/ Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit i Gjykatës Supreme të Kosovës, në përbërje të Antonienette Lepeltier-Durel, kryetare e trupit gjykues, Anne Kerber dhe Sylejman Nuredini, gjyqtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore i Kosovës KKPK/D/R/15/2008, (shkresat e lëndës të regjistruara në AKP me numër AKP 47378), të datës 30 prill 2008, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me 24 gusht 2011, lëshoi këtë

AKTGJYKIM

- 1. Ankesa e J.M. hedhet si e palejueshme.**

2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore i Kosovës KPPK/D/R/15/2008, i datës 30 prill 2008, për sa i përket lëndës së regjistruar me nr. AKP 47378.
3. Shpenzimet e procedurës prej 280€ (dyqindë e tetëdhjetë euro) duhet t'i mbuloj ankuesi, duke bërë pagesën në buxhetin e Kosovës brenda 15 dite nga dita e pranimit të aktgjykimit ose nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

Përmbledhje faktike dhe procedurale:

Me 16 nëntor 2007, S. (P.) V. ka ushtruar padi në Asgjësinë Kosovare të Pronës (AKP) dhe ka kërkuar vërtetimin e të drejtës pronësore dhe riposëdimin e shtëpisë njëkatëshe dhe oborrit që gjenden në një parcelë në rrugën Svete Stefanovic 5 në Prishtinë, të regjistruar me nr. 5879, lista poseduese nr. 3370 të Zonës Kadastrale dhe Komuna Prishtinë, me sipërfaqe prej 346m².

Ai ka deklaruar se ka qenë pronar i kësaj ndërtese, se ka humbur posedimin e ndërtesës me 20 qershor 1999 për shkak të konfliktit të armatosur dhe se tani ajo ndërtesë ishte e uzurpuar në mënyrë të paligjshme nga J.M.. Ai ka theksuar se sipas informatave që ka ndërtesa po shfrytëzohej si çerdhe private për fëmijë.

Për ta mbështetur padinë ai ka dorëzuar në AKP një skicë të vendit ku gjendej ndërtesa bashkë me listën poseduese nr. 3370 nga Zona Kadastrale dhe Komuna Prishtinë, të datës 23 shkurt 2000, e cila tregon se shtëpia dhe oborri ishin të regjistruara në emrin e tij.

Në raportin e saj njoftues, AKP-ja ka konfirmuar se parcela kontestuese ishte uzurpuar nga J.M. në kohën e identifikimit të saj dhe ishte përdorur si çerdhe private për fëmijë. Sekretaria Ekzekutive e ka njoftuar vetë J.M. mbi kërkesën e paraqitur i cili ishte i pranishëm me 22 janar 2008 por nuk kishte nënshkruar letrën njoftuese për pjesëmarrje në procedurën ligjore. Të njëjtën ditë, Sekretaria Ekzekutive ka vendosur një shpallje në derë të oborrit dhe me 4 mars 2008 kishte publikuar padinë. Asnjë palë përgjegjëse nuk kishte parashtruar ndonjë përgjigje brenda afatit prej 30 ditësh nga publikimi.

Raporti verifikues i AKP-së pohon se lista poseduese e dorëzuar ishte gjetur dhe konfirmuar në Zyrën e Kadastrës me 13 shkurt 2008 bashkë me një listë poseduese të lëshuar me 13 shkurt 2008, dhe e azhurnuar, që tregon se S.V. është posedues i së drejtës pronësore.

Me vendimin e 30 prillit 2008, KPPK-ja ka vendosur se paraqitësi i kërkesës kishte vërtetuar të drejtën e pronësisë mbi pronë e kërkuar dhe kishte të drejtë në posedimin e saj dhe se cilido person që ka uzurpuar atë pronë duhet ta liroj brenda 30 dite nga dorëzimi i vendimit.

Paraqitësi i kërkesës e kishte marrë vendimin e KKPK-së dhe ka parashtrua kërkesë për administrimin e pronës nga ana e AKP me 10 korrik 2009.

Me 28 mars 2011, J.M. (në tekstin e mëtejme ankuesi) ka ushtruar ankesë në Gjykatën Supreme kundër vendimit të lartë-cekur.

Në ankesë, ai ka theksuar se nuk ishte lajmëruar për procedurën në AKP-ës dhe ka thënë se e kishte blerë ndërtesën e kontestuar me 2 gusht 1999. Ai ka deklaruar se vendimi i KKPK-së ishte marrë mbi bazën e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Në mbështetje të ankesës së tij ai ka dorëzuar në Gjykatën Supreme këto dokumente:

1. një kontratë të shitblerjes së pronës së kontestuar të nënshkruar nga E.M. si përfaqësues i shitësit dhe ai vetë si blerës, me datë 20 dhjetor 1998 dhe të vërtetuar nga Gjykata Komunale në Prishtinë me 25 korrik 2000 me nr. VR.nr.1292/2000;
2. një autorizim të nënshkruar nga S.V. në vitin 1999 (pa ndonjë detaj tjetër për datën) që i jepet “shokut tim E.M.”, siç ceket në të, për lizing ose shitjen e pronës në fjalë, të vërtetuar me 2 gusht 1999 nga Gjykata Komunale në Kursumli me nr VR. Nr.128/99;
3. Kopjet e letërnjoftimit të E. dhe J.M..

Ankesa iu është dorëzuar djalit të palës përgjigjegjëse në ankesë me 24 maj 2011. Me 20 qershor 2011, S.V. është përgjigjur dhe ka deklaruar se kontrata e dorëzuar është ndryshuar. Ai ka theksuar se në kohën kur supozohet së është nënshkruar kontrata ai kishte qenë akoma duke jetuar në shtëpi. Ai ka deklaruar se kurrë nuk kishte pasur qëllim ta shiste shtëpinë dhe se vetëm ia kishte dhënë mandatin shokut të tij, E.M. për tu kujdesur për të. Ai ka përmendur se kurrë nuk kishte marrë asnjë shumë parash nga shitja e pretenduar.

Arsyetim Ligjor:

Paraprakisht Gjykata Supreme vëren se ankuesi nuk ka dhënë detaje për adresën e vet përveç numrit të telefonit, andaj adresa e lartë-shënuar është e vetmja që figuron në kontratë e shitjes që është dorëzuar.

Pranueshmëria e ankesës

Sipas nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L -079 mbi zgjidhjen e kërkesave që ndërlidhe me pronën private të paluajtshme, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, pala mund të parashtoj ankesë brenda 30 ditësh nga njoftimi i vendimit.

E drejta për parashtrimin e ankesës u takon palëve në procedurën e shkallës së parë të paraparë sipas nenit 348 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (Gazeta Zyrtare 4/77-1478, 36/80-1182, 69/82-1596, e aplikueshme në procedurën aktuale meqë vendimi i KKPK-së ishte lëshuar para se të hyj në fuqi Ligji mbi Procedurën Kontestimore Nr. 03/L-006, sipas nenit 533-1 dhe 538 të ligjit të fundit për zbatueshmërinë në kohën e dispozitave të reja procedurale).

Në rastin konkret, ankuesi nuk ka qenë palë në procedurën e shkallës së parë para KKPK-së. Për ta shpjeguar këtë situatë, ankuesi thotë se ai nuk ka qenë në dijeni për këtë procedurë. Me të vërtetë, në bazë të nenit 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut të ndryshuar me Ligjin Nr 03/L-079: “ *Personi që ka një interes ligjor në padi i cili nuk e ka marrë njoftimin e padisë mund të pranohet si palë në cilëndo fazë të procedurës.*”

Për këtë arsye Gjykata Supreme duhet të shikoj nëse J.M. ishte njoftuar mbi kërkesën e parashtruar. Mënyra për të njoftuar për kërkesën e paraqitur në këtë proces tepër të madh të kërkesave është parashikuar nga neni 10.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079. Sipas kësaj dispozite, Sekretaria Ekzekutive duhet të njoftoj cilindo person përveç paraqitësit të kërkesës i cili aktualisht ushtron ose pretendon se ka të drejtë në atë pronë ose duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme të bëjë njoftimin për kërkesën e parashtruar cilitdo person që mund të ketë një interes ligjor në atë pronë. Dispozita e njëjtë shton se “*në rastet e dubura, përpjekjet e tilla të arsyeshme do të jenë në formë të një lajmërimi në një botim zyrtar të Sekretarisë ekzekutive.*”.

Në rastin në fjalë, operatori i AKP-së ka vëretur se prona ishte uzurpuar nga J.M. i cili ishte i pranishëm dhe të cilit i është dhënë informata për kërkesën e paraqitur. Pasi që J.M. nuk ka nënshkruar asnjë fletë-dëshmi për këtë njoftim, Sekretaria Ekzekutive ka bërë njoftimin e kërkesës së paraqitur me 22 janar 2008, duke vendosur një shpallje në derën e rrethojës që e rrethon pronën. Pastaj publikimi i kërkesës së paraqitur është bërë me 4 mars 2008. Këto masa janë përpjekje të mjaftueshme për njoftimin adekuat të kërkesës së parashtruar. Duke pasur parasysh që afati kohor për të parashtruar përgjigje në kërkesën e paraqitur është 30 nga data e fundit e këtyre datave, J.M. e kishte rastin për të parashtruar përgjigjen e tij deri me 3 prill 2008.

Nga provat e lartcekura, Gjykata Supreme vlerëson se ankuesi kishte disa mundësi po të njëjtat nuk i ka shfrytëzuar që të vihej në dijeni për procedurën dhe të parashtrroj përgjejen e tij në shkallën e parë. Meqë ai nuk është përgjigjur në padi në afatin kohor dhe meqë ai nuk ka qenë palë para KKPK, atij më nuk i lejohet të paraqitet në Gjykatën Supreme për ushtrimin e ankesës. Prandaj kjo ankesë hidhet si e palejueshme në pajtim me nenin 358 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (Gazeta Zyrtare 4/77, 1478,36/80-1182,69/82-1596)

Shpenzimet e procedurës

Në pajtim me Nenin 8.4 të Urdhëresës Administrative (UA) 2007/5 të ndryshuar me Ligji Nr 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretariatit ekzekutiv dhe Komisionit.

Mirëpo në procedurën para Gjykatës Supreme nuk parashihet lirimi nga shpenzime.

Prandaj, regjimi normal i pagesave për taksat gjyqësore të parapara nga Ligji mbi Pagesat e Gjykatës (Gazeta Zyrtare e KSAPK, 3 tetor 1987) dhe nga UD Nr. 2008/02 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e pagesave të Gjykatës janë të zbatueshme ndaj procedurave që sillen para Gjykatës Supreme.

Kështu, për shpenzimet e procedurës së kësaj ankese duhet paguar këto pagesa:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për parashtrimin e ankesë (Neni 10.11 UA 2008/2): €30
- Gjysmë e taksës nga tarifa gjyqësore për lëshimin e aktgjykimit (Neni 10.21, 10.15 dhe 10.1 i UA 2008/2), duke marrë parasysh që vlera e pronës në fjalë mund të llogaritet arsyeshëm në vlerë prej 300 000€: 250€

Këto taksa gjyqësore i paguan ankuesi që e humb rastin.

Sipas Nenit 45 të Ligjit mbi Taksat Gjyqësore, afati i fundit për pagesat e taksave të pa paguara është 15 ditë nga dita kur dorëzohet aktgjykimi. Nëse pagesat gjyqësore nuk paguhen në afatin e caktuar, atëherë do të pasojë përmbartimi i detyrueshëm përfshirë edhe një gjobë sipas Nenit 47 të këtij ligji.

Këshillë Juridike

Në bazë të Nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe i zbatueshëm dhe si i tillë nuk mund të kundërshtohet as me mjete të rregullta as mjete të jashtëzakonshme ligjore.

Nënshkruar nga: Antoninette Lepeltier-Durtel, Kryetare e trupit gjykues

Nënshkruar nga: Anne Kerber, Gjyqtare e EULEX-it

Nënshkruar nga: Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Nënshkruar nga: Urs Nufer, Referent